
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 10.03.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje shtretër për Spitalin e Kardiokirurgjisë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shtretër për përdorim mjekësor 33192100-3

Shtretër spitalorë 33192120-9

Shtretër me motor 33192130-2

Barrela 33192160-1

Karrige me rrota 33193120-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 15,966,666.67 (pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i

LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar

kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërket nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërket operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se **40% e vlerës e fondit limit të objektit që prokurohet**, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërket operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet : b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës e fondit limit të objektit që prokurohet**, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/b, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalohet vlerën e përllogaritur të fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se fondi i përllogaritur i kontratës. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën

vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të

operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast,

autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë të Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e deklaratës. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë certifikatën sipas deklaramit të bërë, e cila duhet të jetë në origjinal ose në kopje të njehsuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme (2 dhe 3) janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti

kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë". Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore. Ky standard është i nevojshëm përse i përket sigurisë dhe efektivitetit të produkteve, duke përmbushur kërkesat rregullatore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë. Një ndër aspektet kryesore të ISO 13485:2016 përfshin dhe Menaxhimin e riskut: Fokus në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore. Përputhshmëria rregullatore: Sigurimi që pajisjet mjekësore përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kontrolli i furnitorëve: Kërkesa për vlerësimin dhe monitorimin e furnitorëve për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

Gjithashtu këto kritere gjejnë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë".

Shënimi "Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e deklaratës. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë certifikatën sipas deklaramentit të bërë, e cila duhet të jetë në origjinal ose në kopje të njehsuar." është në përputhje të plotë me aktet nënligjore të APP-së dhe është vendosur me qëllim lehtësimin e pozitës së operatorëve ekonomikë gjatë ofertimit, në mënyrë që këta të fundit të kenë mundësi të paraqesin certifikatën e prodhuesit, vetëm pasi janë klasifikuar në vend të parë dhe gjithnjë përpara shpalljes fitues.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregtimit të artikujve të tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/8 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikën e Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Thënë ndryshe, një marrëdhënie e qëndrueshme juridiko-civile tregtare midis prodhuesit/distributorit dhe ofertuesit përkthehet në efikasitet dhe llogaridhënie në zbatimin e kontratës. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar mallin objekt prokurimi në cilësi dhe kohë.

Njëkohësisht, ky kriter është vendosur duke mbajtur në konsideratë autoritetin kontraktor përfitues, i cili është qendër spitalore universitare në kuptim të ligjit nr. 55/2022 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rikonstruksioni dhe hapja e dyerve të Spitalit të Ri të Kardiokirurgjisë në QSU “Nënë Tereza” ka një impakt jetik në popullatën e Republikës së

Shqipërisë, e cila, kur bëhet fjalë për çështje shëndetësore specifike të kardiokirurgjisë dhe kirurgjisë vaskulare, do të marrë një shërbim dinjitoz në këtë spital. Ndaj, vlerësohet e domosdoshme që ofertuesi i suksesshëm të ketë një marrëdhënie të formalizuar me furnizuesin/t (prodhues ose distributor i autorizuar) e zgjedhur nga ai për të marrë pjesë në këtë procedurë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqese certifikate konformiteti CE (ose deklarata konformiteti DC) të përditësuara, për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, ose certifikimin FDA.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore,” i ndryshuar, ku në nenin 17 të tij përcaktohet se: “1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të konformitetit të markimit CE. 1/1. Konformiteti i materialit të konsumueshëm me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të certifikimit FDA. 2. Prodhuuesi i pajisjes mjekësore, për të vendosur markimin CE ose certifikimit FDA, sipas çdo klasifikimi pajisjeje, ndjek procedurën e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike për kërkesat thelbësore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Markimi CE nuk është i nevojshëm për pajisjet mjekësore të destinuara për hetime klinike dhe për pajisje me porosi. 4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë ka të drejtë, nëse është paraqitur një kërkesë e arsyetuar për këtë qëllim, të lejojë vendosjen në treg dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore të veçanta, për të cilat nuk janë ndjekur procedurat për vlerësimin e konformitetit, të parashikuara në këtë nen, me kusht që përdorimi i këtyre pajisjeve të jetë absolutisht i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit publik.”

Burimet e së drejtës për certifikimet e kërkuara sipas këtij kriteri bazohen në rregullat e miratuara të Bashkimit Evropian (i.e. Direktiva 93/42/EC, ose Rregullorja 2017/745) apo aktet federale të aplikueshme në rastin e aprovimeve të Administratës së Ushqimit dhe Barnave në SHBA (i.e. Akti Federal për Ushqimin, Barnat dhe Kozmetikën, i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit CE nëse është rasti) ose FDA approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Theksohet se malli objekt prokurimi kanë si destinacion final Spitalin e Kardiokirurgjisë pranë QSUT, dhe duke vijuar arsyetimin për rëndësinë e këtij shërbimi, është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA).

Së fundi, dëshmitë mbi vlerësimin e konformitetit të produkteve, përcaktuar sipas këtij kriteri, vlerësohen si provë e plotë për autoritetin kontraktor, se pjesëmarrësit ofertojnë artikuj që i përmbushin kërkesat e cilësisë dhe sigurisë, duke marrë në konsideratë përdorimin intensiv dhe të shtrirë në kohë, që do t'u bëhet mallrave pranë autoritetit kontraktor përfutues.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:*

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM -së nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimin e konformitetit, mënyrën e shpërndarjes, inspektimin dhe mbikëqyrjen e kësaj pajisje. Kërkesa përse i përket këtij autorizimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit për pacientët, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë / skeda teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogët / skedat teknike të paraqitura, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet teknike sipas DST.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet dhe specifikimet teknike të kërkuara, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë tëknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

8. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë një deklaratë, ku të garantojë se me lidhjen e kontratës pajisjet do të regjistrohen pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM) në përputhje me ligjin nr. 89, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore” dhe se certifikata e regjistrimit do të vihet në dispozicion të AK.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të në të cilën gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Gjithashtu ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 13 “Procesi i regjistrimit” të Ligjit Nr. 89/2014 për “Pajisjet Mjekësore” ku përcaktohet shprehimisht se: “1. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:

a) prodhuesit e pajisjeve mjekësore që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; b) përfaqësuesit e prodhuesve të huaj që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë; c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore.

2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit”.

Sa më sipër, nisur nga natyra sensitive e objektit të prokurimit dhe impaktit të tij, duke marrë parasysh llojet e artikujve që do të furnizohen, të cilat do të përdoren për një kohë të gjatë në Spitalin e Ri të Kardiokirurgjisë, vlerësohet i nevojshëm administrimi i kësaj deklarate në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit nga ofertuesit e mundshëm, duke i krijuar bindjen Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se ofertuesit marrin përsipër të zbatojnë kërkesën e ligjit nr. 89/2014, të ndryshuar, lidhur me regjistrimin e pajisjeve mjekësore të vendosura në treg.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit

për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkthuhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

NR	EMËRTIMI I ARTIKUJVE	NJËSIA
1	Krevat pacienti (4 motor)	Copë
2	Krevat pacienti bariatric (4 motor)	Copë
3	Krevat ekzaminimi	Copë
4	Karroce për persona me aftësi të kufizuara	Copë
5	Karroce për persona bariatric	Copë
6	Barrele për persona bariatric	Copë
7	Barrele	Copë

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1- KREVAT SPITALOR ME 4 MOTOR PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 1)

Specifikimet:

- Shtrat spitalor elektrik me 4 motorë elektrikë të pavarur.
- I përshtatshëm për përdorim në Shërbimin e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare.
- Mundësi kontrolli të pozicioneve të pacientit me anë të telekomandës dhe paneleve anësore.
- Kabulli i telekomandës të jetë material i gomuar dhe rezistent ndaj terheqjes dhe demtimeve të tjera
- Rregullimi i lartësisë së shtratit.
- Rregullimi i shpinës (elevimi i shpinës deri në 70°).
- Rregullimi i këmbëve (flexion/extension).
- Rregullimi i pozicionit Trendelenburg dhe anti-Trendelenburg të paktën ($\pm 15^\circ$).
- Sipërfaqja e shtratit: E përbërë nga 4 segmente (kokë, shpinë, legen, këmbë).
- Materiali i shasisë të jetë çelik i veshur me elektrostatik
- Kapaciteti mbajtës: Minimumi 250 kg.
- Materiali i sipërfaqes: Material antibakterial, rezistent ndaj dezinfektuesve.
- Mundësi për pozicion “Cardiac Chair” (pozicion ulur i pacientit pa pasur nevojë për lëvizje jashtë shtratit).
- Sistemi CPR manual dhe elektrik për ulje të shpejtë të shpinës në raste emergjente.
- Tensioni hyres 220/230V – 50/60Hz.
- Motor DC 24 V.
- Vlerësimi nga sistemet ndërkombetare të ndezshmërisë: UL94V-2.
- Motoret janë me mbrojtje IP66 ekuivalente.
- Mbajtëse për qeset e urinës (2 në çdo anë).
- Duhet të përdoret në ambiente me temperaturë: afërsisht (5 °C - 50 °) grade.
- Lageshtia e ambientit ku do të përdoret: afërsisht (10% - 80%) përqind.
- Presioni atmosferik: afërsisht (700 -1060) hPa.
- Bateri për back-up të rikarikueshme.
- Peshë minimale të jetë jo më pak se: 170 kg.
- Peshë maksimale të jetë jo më shumë se: 280 kg
- Sensor lëvizje ose alarm për daljen nga shtrati të pacientit
- Panel kontrolli për pacientin dhe infermierin (në anësore).
- Panel kontrolli i integruar në mbajtëset anësore.
- Telekomandë me kabllo ose wireless.
- Një telekomandë rezerve së bashku me kabllin
- Mbajtëse anësore (të paktën 2 në secilin krahe, të larta dhe të sigurt, me sistem bllokimi).
- Frenat: Sistemi i frenimit qendror për të gjitha rrotat.
- Rrota: Të paktën Ø125 mm me rrotullim 360°, me sistem frenimi.
- Sistemi i ndriçimit në bazë për pozicionim gjatë natës.
- Sensor për mbi peshën të pacientit.
- Të ketë të paktën dy Port IV pole / mbajtëse serumi.
- Mundësi montimi për pajisje të tjera,
- Mbrojtëse ndaj goditjeve të pjesa e përparme.
- Të gjitha materialet duhet të jenë antibakteriale, antikorrozive dhe lehtësisht të dezinfektueshme.
- Pjesët plastike dhe metalike të jenë pa BPA, pa lateks, dhe me certifikatë biokompatibiliteti.
- Gjatësia totale: 210–230 cm
- Gjerësia totale: 95–105 cm
- Lartësia e rregullueshme: 40–80 cm (nga dyshemeja deri në platformën e shtratit)

Aksesorë të përfshirë:

- Dyshek anti-dekubit me densitet të lartë ose sistem me presion alternativ.
- Gjatesia e dyshekut të jetë 10 cm (+2 cm) më i vogël se gjatesia e shtratit
- Gjerësia e dyshekut të jetë 10 cm (+2 cm) më i vogël se gjerësia e shtratit.
- Baza mbajtëse e dyshekut është plastike e laminiuar kompakte.
- IV Pole.

- Mbajtëse dokumentash dhe mbajtëse monitori
- Mbështetje për rrip sigurie.

Kërkesa të tjera:

- CE Mark / Certifikatë EN ISO 60601-2-52 për pajisje mjekësore të sigurisë.
- Te jete I pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku eshte shkarkuar katalogu
- Garanci minimale: 2 vite.
- Te plotesoje kerkesat sipas standarteve: ISO 13485, CE ose ekuivalenteve te tyre.

2. SHTRAT BARIATRIK ELEKTRIK ME 4 MOTOR PER SPITALIN E KARDIOKIRURGJISE (Artikulli 2)

Specifikimet :

- Shtrat spitalor elektrik bariatrik me 4 motorë elektrikë të pavarur.
- I përshtatshëm për përdorim ne Shërbimin e Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjise Vaskulare.
- Mundësi kontrolli të pozicioneve të pacientit me anë të telekomandës dhe paneleve anësore.
- Kabulli i telekomandës te jete material i gomuar dhe rezistent ndaj terheqjes dhe demtimeve te tjera
- Rregullimi i lartësisë së shtratit.
- Rregullimi i shpinës (elevimi i shpinës deri në 70°).
- Rregullimi i këmbëve (flexion/extension).
- Rregullimi i pozicionit Trendelenburg dhe anti-Trendelenburg të paktën ($\pm 12^\circ$).
- Sipërfaqja e shtratit: E përbërë nga 4 segmente (kokë, shpinë, legen, këmbë).
- Materiali i shasisë të jetë celik i veshur me elektrostatik
- Kapaciteti mbajtës: Minimumi 350 kg.
- Materiali i sipërfaqes: Material antibakterial, rezistent ndaj dezinfektuesve.
- Mundësi për pozicion “Cardiac Chair” (pozicion ulur i pacientit pa pasur nevojë për lëvizje jashtë shtratit).
- Sistemi CPR manual dhe elektrik për ulje të shpejtë të shpinës në raste emergjente.
- Tensioni hyres 220/230V – 50/60Hz.
- Motor DC 24 V.
- Vlerësimi nga sistemet nderkombetare te ndezshmërisë: UL94V-2.
- Motoret jane me mbrojtje IP66 ekuivalente.
- Mbajtëse për qeset e urinës (2 në çdo anë).
- Duhet te perdoret ne ambjente me temperature: afersisht (5 °C - 50 °) grade.
- Lageshtia e ambjentit ku do te perdoret: afersisht (10% - 80%) perqind.
- Presioni atmosferik: afersisht (700 -1060) hPa.
- Bateri për back-up të rikarikueshme.
- Pesha minimale te jete jo me pak se: 200 kg.
- Pesha maksimale te jete jo me shume se: 400 kg
- Sensor levizje ose alarm per daljen nga shtrati te pacientit
- Panel kontrolli për pacientin dhe infermierin (në anësore).
- Panel kontrolli i integruar në mbajteset anësore.
- Telekomandë me kablo ose wireless.
- Nje telekomande rezerve se bashku me kabllin
- Mbajtese anësore (të paktën 2 ne secilin krahe, të larta dhe të sigurta, me sistem bllokimi).
- Frenat: Sistemi i frenimit qendror për të gjitha rrotat.

- Rrota: Të paktën Ø125 mm me rrotullim 360°, me sistem frenimi.
- Sistemi i ndriçimit në bazë për pozicionim gjatë natës.
- Senzor për mbi peshën të pacientit.
- Te kete te pakten dy Port IV pole / mbajtëse serumi.
- Mundësi montimi për pajisje të tjera,
- Mbrojtëse ndaj goditjeve të pjesa e përparme.
- Të gjitha materialet duhet të jenë antibakteriale, antikorrozive dhe lehtësisht të dezinfektueshme.
- Pjesët plastike dhe metalike të jenë pa BPA, pa lateks, dhe me certifikatë biokompatibiliteti.
- Gjatësia totale: ≥ 220 cm.
- Gjerësia totale: ≥ 100 cm.
- Lartësia e rregullueshme: 40–80 cm (nga dyshemeja deri në platformën e shtratit)

Aksesorë të përfshirë:

- Dyshek anti-dekubit me densitet të lartë ose sistem me presion alternativ.
- Gjatesia e dyshekut te jete 10 cm(+2 cm) me e vogel nga gjatësia e shtrati
- Gjerësia e dyshekut te jete 10 cm(+2 cm) me e vogel nga gjerësia e shtratit
- Baza mbajtëse e dyshekut është plastike e laminiuar kompakte.
- IV Pole.
- Mbajtëse dokumentash dhe mbajtëse monitori
- Mbështetje për rrip sigurie.

Kërkesa të tjera:

- CE Mark / Certifikatë EN ISO 60601-2-52 për pajisje mjekësore të sigurisë.
- Te jete I pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku është shkarkuar katalogu
- Garanci minimale: 2 vite.
- Te plotesoje kerkesat sipas standarteve: ISO 13485, CE ose ekuivalenteve te tyre.



3. KREVAT EKZAMINIMI/ EKOGRAFI PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 3)

Specifikimet:

- Krevat ekzaminimi me dimensione jo me te vogla se (200x65/ h=65) cm dhe maximum (210x 75/ h= 75) cm.
- Struktura e shtratit, sipërfaqja dhe kembet te jene prej çeliku inox # 304.
- Ne pjesen e brendshme te kete nje shtrese sfungjeri me trashesi 5cm.
- Mbeshtetja e shpines te jete me kend levizje (0-35°) grade.
- Njera kembe e shtratit te jete pajisur me mbajtese te disponueshme per çarçafet.
- Platforma e shtratit te jete PU me cilesi te larte, me sfungjer me densitet te larte dhe me jastek.
- Ne pjesen fundore kembet te jene te pajisura me tapa plastike kundra rreshqitjes.
- Te jete lehtesisht i montueshem dhe i çmontueshem.
- Ngjyra do te vendoset nga kontraktori.
- Te paktohet ne menyre te tille qe te shmangen demtimet gjate transportit dhe instalimit
- Te plotesoje kerkesat sipas Standartit: ISO 13485, CE ose ekuivalenteve te tij.
- Te jete i pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku eshte shkarkuar katalogu
- Garanci minimale: 2 vite.



Foto reference

4. KARROCE PER PERSONA ME AFTESI TE KUFIZUAR PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 4)

Specifikime:

- Karroce me rrota me kornize te ngurte me material Aliazh alumini.
- Ndenjesja te jete e ngurte me fiber karboni me pjerresi te rregullueshme, e cila siguron ruajtjen e aspekteve dimensionale.
- Te kete disa mundesi manovrimi gjate perdorimit.

- Kendi i kornizes: Kendi i mbyllur 83° grade
- Kendi i hapur 93° grade
- Gjerësia e uleses Min (34x 36) cm, max 46 cm
- Rrotat e pasme (0° -3°) grade
- Mbeshtetësja e kembeve (12- 16) cm
- Lloji i kornizes: Kornize standarte, e ulur
- Lartësia e sediljes se pasme: (36-40) cm
- Lartësia nga dyshemeja e sediljes perpara (45-52) cm
- Lartësia e gjunjëve: (30- 44) cm
- Materiali i uleses: Fiber karboni
- Sistemi i mbeshtetësës: e palevizshme, e fiksuar.
- Lartësia e mbeshtetësës: (25.5- 42) cm
- Kendi i mbeshtetësës nga dyshemeja: (88°- 92°) grade
- Boshti i rrotave te pasme: Alumin i lyer
- Mbeshtetësja e kembeve: e rregullueshme, me mbulese alumini te lyer
- Frenat: Bllokues gershere, Aria
- Lloji i rrotave te pasme: Alumin i anodizuar me goma Schwalbe Right Run
- Mbeshtetese kraheve: ABS i zi me fender
- Mbeshtetese: Me tendosje, e rregullueshme, Aria
- Te jete I pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku eshte shkarkuar katalogu
- Te kete marken CE dhe te jete e projektuar dhe e testuar ne perputhje me standartet UNI dhe ISO 7176 ose ekuvaletet e tyre.

5. KARROCË BARIATRIKE PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 5)

Specifikimet:

- Karrocë transporti e dedikuar për pacientë bariatrikë.
- Konstruktuar për të përballuar peshë të lartë duke ruajtur sigurinë dhe stabilitetin.
- Kapacitet mbajtës: 250 – 400 kg
- Gjerësia e sediljes: 65 – 75 cm.
- Thellësia e sediljes: ≥ 55 cm.
- Lartësia e sediljes nga toka: 45 – 55 cm (për ta bërë të lehtë uljen dhe ngritjen e pacientit).
- Gjatësia totale: ≥ 110 cm.
- Mbështetëse e lartë e shpinës me mundësi rregullimi.
- Mbështetëse këmbësh me rregullim lartësie dhe këndi.
- Mbështetje për kokën
- Brez sigurie për pacientin (3-point ose abdominal).
- Doreza ergonomike për personelin për të zvogëluar lodhjen gjatë shtytjes.
- Kornizë çeliku ose alumini të përforcuar, e veshur me epoxy kundër korrozionit.
- Mbulesa e sediljes dhe mbështetësit të shpinës prej materiali PVC / najloni të papërshkueshëm nga lëngjet, i lehtë për pastrim dhe dezinfektim.
- Mbështetëse krahut dhe këmbësh të fortifikuara, të palosshme ose të heqshme.
- Rrota të mëdha të pasme ≥ 24 inch, të përforcuara për peshë të lartë.
- Rrota të përparme të mëdha ≥ 8 inch, të rrotullueshme 360° për manovrim të lehtë.
- Sistemi i frenimit në të dy rrotat e pasme.
- Mundësi shtytjeje nga personeli (hand push handles të përforcuar).

- Te kete marken CE dhe te jete e projektuar dhe e testuar ne perputhje me standartet UNI dhe ISO 7176 ose ekuvaletet e tyre.
- Te jete i pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku eshte shkarkuar katalogu
- Garancia minimumi 2 vite



Foto reference

6. BARRELË BARIATRIKE PËR TRANSPORT PACIENTI PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 6)

Specifikimet:

- Barrelë spitalore e dedikuar për transportin e pacientëve bariatrikë (obezë), e përshtatshme për përdorim në pavione kirurgjikale dhe urgjencë.
- Struktura e përforcuar dhe e certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë.
- Kapacitet mbajtës: 250 kg deri në 400 kg
- Gjerësi e barrelës : 90 – 110 cm.
- Gjatësi e barrelës : ≥ 220 cm.
- Lartësi e rregullueshme: minimum 45 cm deri në 85 cm.
- Struktura prej çeliku të galvanizuar ose inox, e veshur me epoxy kundër korrozionit.
- Sipërfaqe të lëmuara e të lehta për dezinfektim me solucionet standarde spitalore.
- Te ofroje mundësi për futjen e sirtarit rrëshqitëse të kasetës me rreze X.
- Te jete e pajisur me bazë për bombola oksigjeni dhe me krahe për IV.
- Binarët anësore të palosshme me zbritje të shpejtë
- Te jete antibakteriale dhe lehtësisht e pastrueshme nga njollat dhe papastertite.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Te ofroje mundësi për futjen e sirtarit rrëshqitëse të kasetës me rreze X.
- Rregullim mekanik ose elektrik për:
- Lartësinë e shasisë.
- Pjesën e kokës (pozicion Fowler).
- Pjesën e këmbëve.
- Funkcion Trendelenburg dhe Anti-Trendelenburg (minimum 12°).
- Mekanizëm CPR i shpejtë për shtrirje emergjente.

- Rrota të mëdha minimum 200 mm, të përshtatshme për transport të rëndë.
- Frenim qendror me pedale të aksesueshme nga të dyja anët.
- Opsion drejtimi (5th wheel / rrotë qendrore) për manovrim më të lehtë.
- Shina anësore teleskopike ose të palosshme, të përforcuara, për mbajtjen e pacientëve me peshë të lartë.
- Dyshek anti-dekubitus bariatrik, trashësi ≥ 10 cm, me mbulesë PVC ose poliuretani, të papërshkueshme nga lëngjet.
- Mbajtëse për serume dhe për pajisje monitorimi.
- Kapakë për mbrojtjen e shasisë nga goditjet (bumpers).

Standardet

- Certifikim sipas IEC 60601-2-52 për shtretër/barela spitalore.
- CE Marking ose ekuivalente.
- Prodhuesi të ketë sistem menaxhimi cilësie ISO 13485.
- Te jete i pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun ne web ku eshte shkarkuar katalogu
- Garanci minimale: 2 vite.



Foto reference

7. BARRELE PËR SPITALIN E KARDIOKIRURGJISË (Artikulli 7)

Specifikimet:

- Barele hidraulike prej çeliku me dimensione jo me te vogla se (211x79x61) cm, të veshur me epoksi me lartësi të ndryshueshme në 2 kolona. Te ofroje pozicionin trendelenburg dhe trendelenburg të kundërt.

- Pedale kontrolli hidraulike në të dy anët (trendelenburg, trendelenburg i kundërt, me mundësi për ndryshim lartësie).
- Platforma e dyshekut të jete tërësisht nga material laminat i shtresëzuar. Te jete me katër seksione, me dimensione jo më të vogla se (200x65) cm.
- Te ofroje mundësi për futjen e sirtarit rrëshqitëse të kasetës me rreze X.
- Te jete e pajisur me bazë për bombola oksigjeni dhe me krahe për IV.
- Te jete me timon të lëvizshëm në anën e këmbës dhe doreza të palosshme në anën e kokës.
- Binarët anësorë të palosshme me zbritje të shpejtë.
- Diametri i rrotave të jete jo më i vogël se 200 mm me sistem mbylljeje të njëkohshme.
- Te jete antibakteriale dhe lehtësisht e pastrueshme nga njollat dhe papastërtitë.
- Te suportoje ngarkesën në momente pune jo më pak se 240 kg.
- Ngjyra do të vendoset nga kontraktori.
- Te plotësoje kërkesat sipas standarteve: ISO 13485, CE ose ekuivalenteve të tyre.
- Te jete i pajisur me katalog original në gjuhën shqipe ose angleze si dhe linkun në web ku është shkarkuar katalogu
- Garanci minimale: 2 vite.

Shënim: Për çdo certifikatë, standard, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Argumentimi: *Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike kanë përcaktuar të dhënat minimale teknike, me qëllim ofrimin e një shërbimi mjekësor sa më optimal për pacientin.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT